

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
TOKA "Taste the Mediterranean" Shpk**

Ky akt Themelimi perpilohet nga ortaku Znj. Rudina Guxho, datëlindje 04.04.1974, qytetare shqiptare, me vendlindje në Elbasan dhe banim në Lagja Clirimi, Rruga Mustafa Kotherja, nr.16, Elbasan, e cila me vullnetin e saj te lire dhe ne perputhje me ligjin nr.9901date 14.04.2018 per "Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe me aktet e tjera te legjislacionit shqiptar qe trajtojne keto ceshtje ka krijuar shoqerine shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"),
TOKA "Taste the Mediterranean" Shpk

**NENI 1
Emërtimi**

TOKA "Taste the Mediterranean" Shpk

**NENI 2
Selia**

Selia e Shoqërisë është në adresën: Mengel, Komuna Labinot-Fushe, Ish Frigoriferi i Madh, Elbasan, Zona Kadastrale 2654, Pasuria nr. 1480.

**NENI 3
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë pa afat.

**NENI 4
Objekti i shoqërisë**

Shoqëria ka objekt veprimtarie si me poshtë:

- a - Blerje, perpunim, paketim, etiketim, shitje te ullinjve me origjine shqiptare ose jo brenda dhe jashte kufijve te Shqiperise
- b - Blerje, perpunim, paketim, etiketim, shitje te vajit te ullirit me origjine shqiptare ose jo brenda dhe jashte kufijve te Shqiperise
- c - Blerje te makinerive dhe pajisjeve per perpunimin, paketimin dhe etiketimin e ullinjve dhe vajit te ullirit.

-Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet, shtohet apo kufizohet ne baze të vendimit të Asamblesë se Ortakeve.

NENI 5

Kapitali themeltar

- a- Kapitali themeltar i shoqërisë është **100,000 leke** i cili nuk është i paguar.
- b- Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar ne NENIn 6 (gjashtë) të ketij Akti.

NENI 6 Kontributet

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre te mëposhtme:

- Znj. Rudina Guxho, e datelindjes 04.04.1974, Elbasan të ciles i përket një kuotë me vlerë nominale 100,000 leke, që i korrespondon 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 7 Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

NENI 8 Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

Znj. Rudina Guxho, e datelindjes 04.04.1974, qytetare shqiptare, me vendlindje në Elbasan dhe banim në Lagja Clirimi, Rruga Mustafa Kotherja, nr.16, Elbasan të cilës i përket një kuotë me vlerë nominale 100,000 leke, që i korrespondon 100% të kapitalit të shoqërisë e cila emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e NENIt 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe NENIt 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

NENI 9
Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

NENI 10
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

ORTAKËT

Znj. Rudina Guxho

Datë 04.09.2024